

MENELLA TOTONI

KONSTRUKTE ME FOLJE ASPEKTIVE TË FILLIMIT TË VEPRIMIT NË GJUHËN SHQIPE

Në letërsinë gjuhësore konstruktet me folje aspektive të fillimit të veprimit nuk janë bërë objekt i një studimi tërësor. K. Cipua në sintaksën¹ e tij vetëm sa e prek këtë problem kur flet për aspektin. Në mënyrë të veçantë është marrë me to M. Çeliku në artikullin «Disa togje foljore në shqipen e sotme»², ku skicohet në vija të trasha struktura e këtyre konstrakteve. Po, duke u bazuar në një material tepër të kufizuar, të mbledhur në disa të folme të Shqipërisë së Mesme, ajo paraqitje strukturore nuk është e plotë për shqipen.

Në këtë kumtesë do të bëhet përpjekje për një trajtim sa më të plotë të strukturës së këtyre konstrakteve, duke vënë në dukje sidomos përdorimin e tyre në gjuhën letrare, në një farë mase, përdorimin nëpër dialekte, dhe për një thellim në analizën leksiko-gramatikore të komponenteve të tyre si dhe të konstruktit në tërësi.

* * *

Shqipes i mungojnë mjetet morfologjike për të shprehur aspektin e fillimit të veprimit, po si shumë gjuhë të tjera të sotme indoevropiane edhe ajo e shpreh këtë kuptim me mjete leksikore, me anë të foljeve aspektive, folje me kuptim leksikor të reduktuar, të cilat paraprijnë një folje tjetër që tregon veprim a gjendje. Si të tilla, në shqipe janë foljet: *filloj, zë, nis, marr, vihem, bëj, vij, mbes, qes e hyj*. Duke e parë këtë çështje në plan dialektor, vihet re që për toskërishten janë karakteristike: *zë, bëj e vij*, kurse për gegërishten: *nis, za, marr, vihem, baj, vij, qes, mbes e hyj*. Këto tri të fundit edhe në gegërishte kanë një përdorim mjaft të kufizuar. Në gjuhën letrare të sotme si folje aspektive të fillimit të veprimit përdoren: *filloj, zë, nis, bëj e vij*. Një përhapje më të kufizuar kanë *marr e vihem*. Nga këto folje aspektive *filloj* i përket kryesisht gjuhës letrare. Në toskërishten e folur popullore kjo nuk përdoret. Në gegërishte puna qëndron pak më ndryshe. Në përrallat e mbledhura nga K. Harito (Shkodër) (*Folk. shq. I Pr.pop.*, v. III, f. 436-508) si folje aspektive përdoret më shpesh *filloj* (25 konstrakte me folje aspektive *filloj*, 2 me *nis*, 1 me *za* dhe 2 me *marr*), përkundrazi, në përrallat e mbledhura nga Sh. Hoxha (Lumë) (*Folk. shq. I Pr.pop.*, v. II, f. 473-516) folja *filloj* nuk zë vendin e parë (17 konstrakte me folje aspektive *nis* e 6 me *filloj*). Në përgjithësi edhe në gegërishten e folur popullore ka një përhapje të kufizuar. Te Buzuku gjithashtu nuk gjendet. Të gjitha këto të shtojnë të mendosh se kuptimi aspektiv i kësaj foljeje është i ri dhe i lidhur kryesisht me gjuhën letrare. Përdorimi i

1) K. Cipo, *Sintaksa*, f. 54 v. e 56.2) M. Çeliku, *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, «Bul. i USHT, Seria Sh. Sh.», 1963, 1, f. 162 v.

foljes *filloj* si folje aspektive në gegërishten e folur popullore ndoshta duhet parë si ndikim i gjuhës së shkruar. Po, në qoftë se për gegërishten duhen gjurmime më të thella për të arritur në rezultate të sakta, për toskërishten kjo është e sigurt. Edhe në gjuhën letrare kjo është bërë sundonjëse këto 20-30 vjetët e fundit, sepse në veprat e shumë shkrimtarëve të shekullit të kaluar dhe të fillimit të shekullit tonë nuk gjendet. Kështu p.sh. te Naimi, te Samiu, te Gramenua etj. si folje aspektive e fillimit të veprimit del folja *zë*, te Noli (*Historia e Skënderbeut*) del folja *nis*. Përhapja gjithnjë më e madhe në gjuhën letrare e foljes *filloj* si folje aspektive shpjegohet me faktin që kuptimi i parë leksikor i saj është kuptimi aspektiv, që në çdo përdorim të saj në masë të ndryshme e ruan kuptimin e fillimit të veprimit. Në foljet *zë*, *nis* etj., përkundrazi, kuptimi aspektiv nuk është kuptimi i parë, themelor. Në kuptimet e para të këtyre foljeve nuk del aspak si mbishtresë kuptimi i fillimit të veprimit: krahaso: *zë peshk*, *zë vendin*, *zë vrimat*, *zë miqësi*, *nis nusen*, e *nis dikë* për diku etj. dhe *zë (nis) të punoj*, *zë (nis) punën*. Aftësia e foljeve *zë* e *nis*, sidomos e *zë*, për të fituar kuptimin e fillimit të veprimit, kur ndiqet nga një emër në kallzore, është tepër e kufizuar, kurse përkundrazi për *filloj* është e pakufizuar, ajo është në natyrën e saj. Kështu mund të thuhet: *filloj (edhe nis) përgatitjen*, *filloj ngjitjen*, *filloj qitjen* etj., po s'mund të thuhet: *zë përgatitjen*, *zë (nis) ngjitjen*, *zë (nis) qitjen* etj.

Ndryshe nga foljet që shërbejnë si bërthama kallzuesore të fjalisë, kur përdoren si folje aspektive, *filloj*, *zë*, *nis* etj. nuk shprehin veprime ose gjendje, ato janë qendra leksikore të dhënjes së aspektit të një veprimi. Foljet *zë*, *nis* si të tilla nuk ruajnë asgjë nga kuptimet e tyre të para e, si edhe folja *filloj*, duhet të pasohen nga një folje që shpreh veprim ose gjendje. Folja *filloj*, kur përdoret si bërthamë kallzuesore e një fjalisë, fiton edhe një kuptim leksikor të ri, shpreh veprim ose gjendje, i cili bëhet i qartë nga njera prej gjymtyrëve emërore të fjalisë, që përmban idenë e veprimit, p.sh.: *fillon (zë, nis) shiu* do të thotë *fillon (zë, nis) të bjerë shi*, *filloj (nis) përgatitjen* do të thotë *filloj (nis) të kryej përgatitjen* etj.

Duke përjashtuar *filloj*, *zë*, *nis* e mbes foljet e tjera karakterizohen nga ngjyrimet aspektive suplementare. Foljet *marr*, *vihem*, *bëj* e *qes* në këto raste tregojnë jo vetëm fillimin e veprimit të shprehur nga folja që i pason, po edhe një hyrje energjike e të shpejtë në të.

«U shkëput nga kosovarja dhe *mori* e *tha* shpejt e shpejt:» (J. Xoxa, *Lumi i vdekur* I, 187), «U kish ardhë Agve ni letër, / *Merr me e kundue* Dezdar Ag Osmani», (*Këngë pop. legj.*, 218), «Dhe si u ngrit, u kap pas degëve dhe *mori t'i ngjitej* pishës» (J. Xoxa, *Lumi i vdekur* III, 266), «E *vehet* e *han* për kadalë, me ia pasë lakmi. » (*Prralla Kombtare*, 27), «I pëlqeu dashit ai kshill, kceu gardhin e *vehet* me ecë mbas gomarit.» (*Folk. shq. I Pr. pop.*, v I, 109), «Bali duhej të takonte pa tjetër Luanin dhe *u vu të kërkonte* nëpër Institut.» (N. Jorgaqi, *Dashuria e Mimosës*, 198), «Kur *ka ba dielli me le*, aj ia behë m'nji rrah të blirë, ...». Kur bëri makina të *shkonte* të gjithë ja dhanë kujes sikur ndaheshin me njerëz të vdekur.» (TH. Kacori, *Ditë që s'harrohen*, 26), «Ka *qitë* njana e i *paska thanë*» (*Folk. shq. II Epika legj.*, v. I, 60).

Përkundrazi foljet *vij* e *hyj* tregojnë një hyrje të qetë e të ngadaltë në veprimin e shprehur nga folja që i pason:

«Divi veç *vjen* e *ligshtohet*:» (*Prralla Kombtare*, 113), «Kur i lije në degë gjer më dy javë të vjeshtës, *vinin* e *bëheshin* rrekëz e merrnin të

plasur e shkruheshin vija-vija...» (J. Xoxa, *Lumi i vdekur* I, 207), «Ai erdh e u ligëtua si një i sëmurë». (Dhe. Xhuvani, *Kambana e fundit*, 40), «— Paskë kenë jetëgjatë — i thotë gomari — edhe na kemi pasë rreziqe gjithfarësh e me hi e me t'i distue s'mbarojmë kurrë;» (*Folk.shq. I Pr.pop.*, v. I, 110), «E me ta t'kan hi me e rrafë / T'mjerën orë të karadakut,...».

E parë nga kjo pikëpamje folja *mbes.* si edhe *filloj*, *zë*, *nis*, shpreh vetëm fillimin e veprimit.

«Qaty te e vona mbet ma i madhi e foli:» (*Prralla Kombtare*, 44).

Këto folje e bjerin kuptimin konkret të tyre dhe fitojnë kuptimin aspektiv të fillimit të veprimit në konstrukte të caktuara. Për foljet *zë*, *nis*, *marr*, *vihem* e *filloj* këto konstrukte janë:

I — Konstrukte me bashkërenditje:

a) folje aspektive + e (edhe) + folje në dëftore:

«Si iku djali zuri mëma e qante e i tha burrit:» (*Folk.shq. I Pr.pop.*, v. I, 211), «Një ditë, tuj pasë mbetë pa kokrrën e drithit në shpi, *xen* e i thotë ma të madhit.» (*Prralla Kombtare*, 14), «Atëhere plaka *nis* e flet (*Po aty*, 14), «Zuri edhe i rëfeu kyj të tëra të vuajturat e tij.» (*Folk.shq. I Pr.pop.*, v. I, 187). «Kjo me të ardhur i vëllai, na *zë edhe qan.*» (*Po aty*, 119), «Ai ka bërë lira pa esap edhe tani *ka zënë edhe bën* para të ergjën-da shumë të mëdha, bara me një potkuanjë.» (*Mbl. të hersh. të folk. shq.*, I, 405).

b) folje aspektive + folje në dëftore:

«Si lëçuan shumë njerës nga hekurat dhe këtë e mbajtën lidhur, *zuri po qante.*» (*Mbl. të hersh. të folk. shq.*, I, 302), «Ustai diç do të kishte biseduar me Ireneun se *zu* i qëndronte Kolës çekan mbi kokë.» (S. Andoni, *Kandili i shuar*, 90).

II — Konstrukte me nënrenditje:

a) folje aspektive + folje në lidhore:

«Pastaj ne filluam të largoheshim.» (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 28), «U gëzua motra edhe *zuri të lonte* me të.» (*Folk. shq. I Pr. pop.*, v. I, 190), «Mbi to kishte nisur të frynin erërat e dimrit.» (I. Kadare, *Gjenerali...*, T. 1963, 102), «Merr përsëri të dalë po Sheja e ndal.» (S. Pitarka, *Familja e peshkatarit*, 39).

b) folje aspektive + folje në paskajore.

«Andrrimet Shpresën e pushtojnë./ gjumi fillon me e kotë...». (Ll. Siliqi, *Vjersha dhe poema*, 74), «Po zan' hyjet me u venitë,...». (K. Jakova, *Flladi i Tetorit*, 36), «Ka nisë drita bjeshkve me *ague.*» (*Këngë pop. legj.*, 270), «U prin atyne 600 vetve e merr me *kthye* tu mbreti.» (*Prralla Kombtare*, 23), «U çue e u vu m'u sjellë nëpër terr.» (*Po aty*, 109).

c) Folje aspektive + përcjellore:

«Nisi plaka to bo hismet t'çudiçëm,...» (*Folk. shq. I Pr. pop.*, v. II, 499), «Mbretit sot n'sabah i kanë pru ni nuse t're, ja ka pru ni plakë ene *kanë nisë to i çue* nuses shumë bakshëjshe.» (*Po aty*, 500), «I çau

hararët ky çuni e *zu tu hallakatë* melin e gjithë, se i tha kali kti çunit:-> (Po aty, v. III, 365).

Konstruktet me bashkërenditje janë karakteristike për gjuhën e folur popullore, sidomos për toskërishten. Gegërishtja në krahasim me toskërishten i përdor më rrallë. Konstrukte të tilla hasen edhe në gjuhën e shkruar letrare, sidomos tek ata autorë që qëndrojnë pranë gjuhës së folur popullore, po në krahasim me konstruktet me nënrenditje ato janë shumë të rralla.

Konstruktet me lidhore janë karakteristike për gjuhën letrare të shkruar. Në toskërishten e folur, siç do të duket qartë edhe nga tabela që do të jepet më poshtë, nuk janë konstrukte mbisunduese. Në gegërishten e folur hasen tepër rrallë. Një përhapje më të gjerë kanë në gegërishten e shkruar.

Konstruktet me paskajore janë karakteristike për gegërishten e folur dhe të shkruar. Në gegërishten e shkruar më shumë se në gegërishten e folur popullore paskajorja në këto konstrukte po zëvendësohet nga lidhorja.

Konstruktet me përcjellore janë karakteristike për disa të folme të gegërishtes si: të folmet e Shqipërisë së Mesme, të Dibrës etj. Në krahasim me konstruktet e tjera janë tepër të rralla.

Këto që u thanë më lart, bëhen të qarta nga kjo tabelë statistikore:

	V e p r a	K. me bashkërenditje		K. me nënrenditje		
		me lidhëza	pa lidhëza	lidhore	paskajore	përcjellore
Toskërishtja e folur	Përralla të mbledhura nga H. Pedersen (Mursi-Sarandë).	26	2	3		
	Përralla të mbledhura nga K. Harito (Përmet) (Folk. shq. I Pr. pop. v III, f. 82-125).	2	6	5		
Gegërishtja e folur	Përralla të mbledhura nga K. Harito (Shkodër) (Folk. shq. I P. pop., v. III, f. 436-508)	2		1	27	
	Përralla të mbledhura nga Sh. Hoxh (Lumë) (Folk. shq. I Pr. pop., v. II, f. 473-516).	8		1	10	3
Gegërishtja e shkruar	N. Nikaj: <i>Shkodra e rrethume</i> (f. 21-78)				56	
	H. Stërmilli: <i>Sikur të isha djalë</i> (f. 17-69).			2	8	
	Migjeni: Proza			19	7	
Gjuha letrare	F. Noli: <i>Historia e Shënderbeut</i> , bot. II, T. 1962			28		
	A. Abdihoxha: <i>Ëndra dhe dritë</i> (f.66-143).			27		
	G. Kongoli: <i>Vajza me vathë të kuq</i> (f.3-57).			26		

Foljet *vij*, *qes*, *mbes* e *hyj* si folje aspektive përdoren vetëm në konstrukte me bashkërenditje, ndërsa *bëj* vetëm në konstrukte me nënrenditje.

Struktura e konstrukteve me nënrenditje që kanë si komponente të dytë një folje në paskajore ose përcjellore, është e thjeshtë, meqë komponentja e dytë nuk ndryshon. Në konstruktet me bashkërenditje dhe në ato me nënrenditje ku komponentja e dytë është një folje në lidhore, ajo paraqitet më e ngatërruar. Për këtë arsye kësaj i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë, aq më tepër që përdorimi i një foljeje në dëftore e lidhore në këto konstrukte përbën një karakteristikë vetëm të shqipes dhe të ndonjë gjuhe tjetër të Ballkanit.

Struktura e këtyre konstrukteve, kur folja aspektive është në dëftore, paraqitet e tillë:

	Konstrukte me bashkërenditje		Konstrukte me nënrenditje	
	Folja aspektive	Komponentja II	Folja aspektive	Komponentja II
1	e t.	e. t. dëft.	e t.	e t. lidh.
2	e pkr.	e pkr. "	e pkr.	e pkr. "
3	e kr.th	e. t. "	e kr. th.	e t. "
4	" " "	e pkr. "	" " "	e pkr. "
5	" " "	e kr. th "	" " "	" " "
6	e kr.	e t. "	e kr.	e t. "
7	" "	e kr. "	" "	" "
8	e kr.pl.	e pkr. "	e kr. pl.	e pkr. "
9	" "	" "	e ardh. e t.	e t. "

Nga kjo paraqitje del që në planin kohor (sidomos për toskërishten e folur dhe gjuhën letrare) struktura e konstrukteve me bashkërenditje në vija të përgjithshme është e njëllajtë me atë të konstruktve me nënrenditje. Vetëm strukturat 5, 7 (e *kryer* e *thjeshtë* + e *kryer* e *thjeshtë* dhe e *kryer* + e *kryer*) të konstrukteve me bashkërenditje nuk mund të realizohen në konstruktet me nënrenditje. Struktura 9 (e *ardhme* e *tashme* + e *tashme*) e konstrukteve me nënrenditje nuk është hasur e realizuar në konstruktet me bashkërenditje. Në gegërishte, për shkak të përdorimit të kufizuar të konstrukteve me bashkërenditje, disa struktura si 2, 4, 8 (e *pa kryer* + e *pakryer*, e *kryer* e *thjeshtë* + e *pakryer*, e *kryer* e *plotë* + e *pakryer*) nuk janë gjetur të realizuara në letërsinë që është konsultuar. Konstruktet me strukturë e *kryer* + e *kryer* janë të kufizuara, hasen në gegërishten veriore, e aty-këtu edhe në gegërishten e shkruar, në poezinë epike.

Komponentja e parë, duke mos shprehur veprim ose gjendje, nuk ka një ekzistencë semantike të pavarur dhe lot kështu rolin e një foljeje gjysmëndihmëse. Të dyja foljet formojnë nga kjo pikëpamje një të tërë unike, me një përmbajtje komunikative të vetme, ku peshën semantike e mban komponentja e dytë e konstruktit, kurse e para tregon aspektin e veprimit që shprehet nga komponentja e dytë. Duke qenë i përcaktuar në fillimin e tij, veprimi i shprehur nga konstrukte të tilla paraqitet si një proces që zgjatet, që fillon dhe vazhdon të kryhet. Le të krahasohet p.sh. *punova* që shpreh një veprim të kryer, dhe *fillova të punoja* që shpreh një veprim i cili, pasi ka filluar në një mo-

ment të caktuar të kohës së shkuar, vazhdon të kryhet brenda caqeve të kësaj kohe. Aspekti i vazhdimësisë që fiton konstrukti, duket sidomos në shembuj të tillë: «Yjtë zunë të rrallohen, Kapedan!» (Th. Kacori, *Për mëmëdhenë I*, 27), ku *zunë të rrallohen* shpreh një veprim që ka filluar para momentit të ligjërimit dhe vazhdon edhe gjatë këtij momenti. Në këto konstrukte komponentja e parë shpreh kohën kur fillon veprimi, ndërsa e dyta kohën, gjatë së cilës vazhdon të realizohet ky veprim. Duhet vënë në dukje që, kur komponentja e dytë është një folje në të pakryerën, kjo e pakryer nuk i ruan më ato kuptime aspektive (vazhdimësi e përsëritje), që ka në përdorim të pavarur. Këto kuptime aspektive këtu shprehen ose nga konstrukti në tërësi (vazhdimësia), ose nga folja aspektive (përsëritja).

Nga pikëpamja gramatikore komponentja e dytë varet nga e para nga folja aspektive. Kjo duket jo vetëm në konstruktet me nënrenditje, po edhe në përdorimin në disa raste të një trajte kohore të caktuar të komponentes së dytë në varësi nga trajta kohore e komponentes së parë, gjë që do të bëhet e qartë nga analiza strukturore-semantike e mëposhtme.

a) Kur komponentja e parë është në të tashmen, e dyta është në të tashmen. Në këto raste flitet për një veprim të vazhduar, të kryer para momentit të ligjërimit ose pas tij.

Kur veprimi kryhet para momentit kur flasim, të dyja komponentet kanë kuptimin e një të tashmeje historike:

«Mitrolozët tanë fillojnë të rrahin ballistët e Skroskës.» (M. Shehu, *Kujtime nga jeta e Brig. I sulmuese*, T. 1959, 21), «Një ditë, tuj pasë mbetë pa kokrën e drithit në shpi, *xen* e i *thotë* ma të madhit» (*Prralla Kombtare*, 14).

Kur veprimi kryhet pas momentit të ligjërimit, e tashmja e të dyja komponenteve ka kuptimin e së ardhmes:

«Po arriti gjer atje, *zënë e dalin* vetë...» (J. Xoxa, *Lumi i vdekur I*, 106), «—Ç'bëjmë? *Fillojmë të gdhendim?* I rashë me bryl skulptorit dhe shkela bishtin e cigares me këmbë në çimenton e studjos» (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 7).

Në disa raste, kur flitet për të dhëna të përhershme të nxjerra nga eksperiencia, të dyja komponentet në të tashmen kanë kuptim mbarëkohor:

«Fletët, të zverdhura pakëz nga vapa e atyre ditëve, përplaseshin me njëra tjetrën, si krahët e një zogu kur *nis e fluturon*». (F. Gjata, *Kënetë*, 298), «E kur piqet buka e re, *zënë e dalin* xixëllojat.» (N. Prifti, *Çezma e floririt*, 165).

Vetëm në qoftë se folja aspektive shoqërohet nga pjesëza *po*, në një strukturë të tillë mund të shprehet një veprim që fillon në momentin e ligjërimit:

«*Po fillon të mos më pëlqejë* kjo dhomë dhe kjo kohë idiote — mendova me vehte.» (D. Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, 49).

b) Kur komponentja e parë është në të kryerën, e dyta është në të tashmen. Me një strukturë të tillë shprehet një veprim që ka filluar të kryhet para momentit të ligjërimit, vazhdon dhe do të vazhdojë edhe pas tij. Pikërisht për këtë arsye komponentja e dytë përdoret vetëm në të tashmen. Po këtu është e domosdoshme të vihet në dukje që fillimi i veprimit kuptohet si një proces veprimi që ka filluar para momentit të ligjërimit dhe vazhdon deri në këtë moment. «*ka zënë e bie* në shëmbullin: «Nëna jashtë *ka zënë e bie* shi dhe qielli... është errësuar

pak.» (S. Pitarka, *Familja e peshkatarit*, 75) do të thotë që ç'shi ka rënë deri në momentin e ligjërimit është fillimi, ai do të vazhdojë të bjerë edhe pas këtij momenti. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për she-mbujt e tjerë:

«Edhe gruaja, megjithëse ka filluar të plaket, mua më duket më e dashur më e sjellshme». (N. Prifti, *Tregime të fshatit*, 102), «Pali/Nuk e ka mbajtur atëhere, por tashti ka nisë të sillet shumë mirë me të. (K. Jakova, *Toka e jonë*, 11).

c) Komponentja e dytë është gjithashtu në të tashmen, kur e para është në të ardhmen. Kjo strukturë shpreh një veprim që do të fillojë e do të vazhdojë pas momentit të ligjërimit. E tashmja e lidhëses ka kuptimin e së ardhmes:

«Siç vendosi plenumi i Komitetit Qendror, riorganizimi i shkollës do të fillojë të zbatohet gradualisht nga viti shkollor 1963-1964» (E. Hoxha, *Raport... mbajtur në Kongresin IV të PPSH*, 101), «Do të më merret goja, do të më mbytin djersët dhe s'do të shpreh dot gjë. Pa do të fillojnë pastaj të qeshin me mua.» (Sh. Musaraj, *Para Agimit II*, 72), «Prapë do të fillojnë të thenen.» (A. Abdihoxa, *Tri ngjyra të kohës*, I, 21).

ç) Kur komponentja e parë është në të pakryerën, edhe e dyta është në të pakryerën. Një strukturë e tillë përdoret për të shprehur një veprim të vazhduar që përsëritet:

«Toka avullonte si bukë e valë që nga mëngjezi, më të rënë dielli, dhe gjer nga pasdrekja vonë, kur dita zinte thyhej (Th. Kacori, *Për mëmëdhenë I*, 11), «Po çdo mendim që i vinte e plan që niste të hartonte ja prishte kujtimi i asaj ngjarjeje të shëmtuar me ballistët». (Sh. Musaraj, *Para agimit*, I, 285).

d) Kur folja aspektive është në të kryerën e thjeshtë, komponentja e dytë mund të jetë në të pakryerën ose në të tashmen.

1 — Struktura që e ka komponenten e dytë në të pakryerën, shpreh një veprim, fillimi dhe vazhdimi i të cilit i përkasin periudhës kohore para momentit të ligjërimit. Vazhdimi i këtij veprimi nuk ka të bëjë aspak me momentin e ligjërimit.

«Shërbëtori zu e po i tregonte shkakun e udhëtimit.» (*Folk. shq. I Pr.pop.*, v. I, 420), «Pastaj nisi të ndërtonte një tjetër fortesë në kep të Rodonit, atje ku derdhet Drini në det, që të kishte ku të tërhiqej në kohën e invazjeve turke». (F. Noli, *Historia e Skënderbeut*, T. 1962, 74), «Baluket e njomura nga djersa filluan t'i rrihnin fytyrën si bishtra shëgjettle». (J. Xoxa, *Lumi i vdekur I*, 120).

2 — Struktura që e ka komponenten e dytë në të tashmen, shpreh një veprim që ka filluar dikur para momentit të ligjërimit dhe vazhdon edhe në këtë moment. Në këtë fragment poezie popullore: «Zunë yjt e rrallëtojnë, / ksenetarët zunë e shkojnë. / Gjithë venë e ti s'po tunde / lumi s'sjell për dit kërcunje. / (Kënga e popullit, T. 1955. 101), ku gruaja i flet burrit të saj që do të shkojë në kurbet, si veprimi i të rralluarit dhe ai i të shkuarit kanë filluar para se gruaja t'i drejtohet burrit, por ndërkaq ato vazhdojnë edhe në momentin kur flet ajo.

«— Ti ke ndryshuar që kur zure të shoqërohesh me Dritën e me rrethin e saj». (A. Abdihoxa, *tri ngjyra të kohës I*, 68), «— Elsa! — foli me zë të ulët vajza e vogël. Shi zuri të bjerë kështu përjashta?»

Me një strukturë të tillë mund të shprehet edhe një veprim që do të fillojë të kryhet pas momentit të ligjërimit. Në këto raste e kryera e thjeshtë e foljes aspektive ka kuptimin e së ardhmes:

«— Po unë? Po kompania? Për nder, po s'erdhi zëvendësi yt brenda javës, *fillova të ngre sovjetët përsëri dhe do t'u pres mjekrën gjithë hoxhallarëve dhe priftërinjve.*» (Q. Buxheli, *Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*, 21).

Në mjaft raste e tashmja e komponentes së dytë ka kuptimin e një të tashmeje historike; në shembujt e mëposhtëm kjo gjë bëhet e qartë edhe nga përdorimi në po atë kontekst i foljeve të tjera në të tashmen.

«Pas pak moti *zu e po i vjen* rëndom zonjës një plakë, e cila një ditë e *mëson* atë të *pyesë* të shoqin ku e *ka* shpirtin e fuqin'e tij. Edhe ajo e pyeti, po ay s'i rrëfente». (Folk.shq. I Pr.pop., v. I, 154). «Ene gjali hiç s'po *mërzitet*. Nisi menjëherë e po çron plepat. Për pesë ditë i çrçoi,...» (Folk. shq. I Pr. pop., v. II, 498), «Mbi pyll *zmadhohet* ngadalë një si shkumë, e mbushur me dritë hëne. Ndërsa *afrohem* drejt saj xhamet e kabinës *fillojnë të vishen* me cirkëza uji si kristal. Në fillim reja ishte e bardhë, e butë, e lehtë po pak nga pak ajo u nxi dhe mbuloi tërë pyllin. *Zuri të bjerë shi*».

Në gjuhën e shkruar që prej Rilindjes vërehet një prirje e tillë, sipas së cilës komponentja e dytë në vend që të jetë në të pakryerën është në të tashmen.

«Në dritën e saj shumë nga të pranishmit njohën njeri tjetrin dhe *filluan të shkëmbejnë fjalë e të ndezin cigare*». (Sh. Musaraj, *Para agimit* I, 237), «U ulën të gjithë në sofër dhe *filluan të hanë* në heshtje». (D. Shaplo, *Përtëritje*, 17).

Kjo prirje thua se është rregull te autorët gegë (në ato raste ku përdorin lidhoren si komponente të dytë), po vërehet jo rrallë edhe te disa autorë të ditëve tona si: J. Xoxa, Sh. Musaraj, D. Agolli, F. Gjata etj. Te ndonjë autor si Dh. Shuteriqi kjo prirje është bërë e ndërgjegjshme, sepse një zëvendësim i tillë është përgjithësuar jo vetëm në këtë strukturë, po në të gjitha të tjerat, duke iu shmangur kështu gjuhës së folur.

Po të bënim një statistikë, do të na paraqitej një tablo e tillë:

	Autori	Vepra	E tasme	E pakryer
1	H. Stërmilli	« <i>Sikur të isha djalë</i> » (f.17-64)	2	—
2	G. Kongoli	« <i>Vajza me vathë të kuq</i> » (f.3-57)	21	1
3	Migjeni	<i>Proza</i>	13	3
4	J Xoxa	« <i>Lumi i vdekur</i> », I (f.7-85)	20	6
5	D.Agolli	« <i>Zhurma e erërave të dikurshme</i> », (f.3-57)	27	9
6	A.Abdihoxha	« <i>Ëndra dhe dritë</i> » (f.66-143)	9	17
7	F.Noli	« <i>Historia e Skënderbeut</i> » bot.II, T. 1962	4	18
8	N.Frashëri	« <i>Të vegjëlit</i> » (proza)	—	6

Një zëvendësim i tillë nuk ndodh në toskërishten e folur. Në përrallat e mbledhura në Mursi nga Pedersenin në asnjë rast e pakryera nuk zëvendësohet nga e tashmja. Në toskërishten e folur edhe në qoftë se ndodh një gjë e tillë, ajo përdoret si një e tashme historike. Gegërishtja e folur popullore nuk mund të merret në konsideratë për shkak të përdorimit të paskajores në këto raste si komponente e dytë. Për mendimin tim ky fenomen e ka burimin në gegërishten e shkruar, ku lidhorja gjithnjë e më shumë po zëvendëson paskajoren (shih për këtë tabelën e parë). Autorët gegë nën ndikimin e së folmes së tyre shpesh nuk arrijnë të kuptojnë dallimin kohor që bën toskërishtja në përdorimin e së tashmes

dhe të së pakryerës në këto konstrukte e përgjithësisht kur lidhorja varet nga një folje tjetër. Për ta e tashmja në këto konstrukte është po aq neutrale nga pikëpamja kohore sa edhe paskajorja, Ç'qëndrim duhet të mbajnë shkrimtarët ndaj këtij fenomeni gjuhësor? Mendoj që një prirjeje të tillë i duhet prerë rruga në letërsi, sepse rrudh mundësitë shprehëse të shqipes.

dh) Kur komponentja e dytë është në të kryerën e plotë, e dyta është në të pakryerën. Me këtë strukturë shprehet një veprim që ka filluar të kryhet para një veprimi që i përket kohës së shkuar, dhe vazhdon të kryhet krahas me të ose dhe pas tij. Edhe këtu, si në rastin e përdorimit të foljes aspektive në të kryerën, duhet vënë në dukje që fillimi kuptohet si proces veprimi që ka filluar të realizohet dhe vazhdon deri në momentin kur kryhet veprimi tjetër. Le ta sqarojmë me një shembull: «*Kish filluar të zbardhte*, kur në odën e të plagosurit *hyri* duke ecur mbi majë të këmbëve, Nuz Bathorja». (Sh. Musaraj, *Para agimit*, 115), ku *kish filluar të zbardhte* do të thotë që procesi i të zbardhurit është në fillimin e tij deri sa hyn në odë Nuz Bathorja. Ky veprim i qëndron larg momentit të ligjërimin e pikërisht për këtë arsye në këtë strukturë komponentja e dytë është në të pakryerën. Përdorimi i së tashmes, në vend të së pakryerës, që vërehet te disa autorë: «Përjashta era *kishte filluar të fryjë* me të madhe». (Dh. Xhuvani, *Kambana e fundit*, 50) është artificial dhe jo në pajtim me gjuhën e folur popullore dhe me përdorimin e rëndomtë në gjuhën e shkruar, prandaj edhe duhet mënjanuar nga gjuha e shkruar. Arësytet e një përdorimi të tillë të së tashmes në vend të së pakryerës në këtë strukturë janë po ato që u përmendën më lart.

e) Në këtë mes një vend të veçantë zënë konstruktet me bashkërenditje, ku të dyja komponentet janë në të kryerën e thjeshtë. Ndryshe nga strukturat e përshkuara më lart, në këto përcaktohet në vija të përgjithshme jo vetëm fillimi i veprimit, po edhe mbarimi i tij. Janë karakteristike për gjuhën e folur popullore; në gjuhën e shkruar kanë një përdorim më të kufizuar. Si folje aspektive përdoren foljet *zë*, *marr*, *vihem*, *vij* e *mbes*.

«*Zuri edhe i rëfeu kyj të tëra të vuaiturat e tij*». (*Folklor shq. I Pr. pop.*, v. I, 187), «*U bind kadija për atë farë pleqnije e muer e tha: (Prralla Kombtare, I, 43), «Mbasi shkuan doktorët mora e i shkrova Shpendit.*» (H. Stërmilli, *Sikur të isha djalë*, 154), «*U vu grueja e ia dëftoi gjithsesi punën.*» (*Prralla Kombtare I*, 59), «*Qysh erth e u ashpërua, / edhe mori me nxit malë, /»* (N. Frashëri, *Historia e Skënderbeut*, T. 1953, 145) «*Met e foli Sokole Halili.*» (*Këngë pop. legj.*, T. 1955, 201).

Në gegërishten veriore dhe aty-këtu edhe në gegërishten e shkruar po me këtë kuptim përdoret edhe konstrukti me të dyja komponentet në të kryerën:

«*Ora para Halitit, i ka dalë/paska qitë e i paska thanë.*» (*Folklor shq. II Ep. legj.*, v. I, 64), «*E, kur Dila pati mbledh filxhanat / ka marrë Gjetja e grues kështu m'i ka thanë.*» (M. Gurakuqi, *Gjeto Plaku*, 5).

* * *

Duke përfunduar ç'është thënë më sipër për konstruktet me folje aspektive të fillimit të veprimit, mund të pohohet:

1) Struktura e konstrukteve me bashkërenditje dhe e atyre me nënrenditje është pothuajse e njëjtë, sidomos po të kemi parasysh toskërishten. Pohimi i M. Çelikut për konstruktet me bashkërenditje se «Kur komponenti i dytë asht një folje e shtjellueme, atëhere kohët e këtyne

foljeve korrespondojnë³: mbështetet në një material të kufizuar e për këtë arsye karakteri kategorik i tij ndoshta duhet vënë në dyshim; sidoqoftë për gegërishten në përgjithësi ky pohim nuk vërtetohet. Në gegërishten e folur hasen konstruktë me strukturë: *e kryer e thjeshtë + e + e tashme*: «U theva ni rrem lisi, nisi e po xhimon beshka» (Folk. shq. I Pr. pop., v. II, 510), «Vllai i vol nisi e po kon, se xhithë to shkue po kët to keshtë, vllonë e vol.» (Po aty, 485) ose *e kryer + e + e tashme*: «kanë nisë gurrat e po i turbullojnë», (Folk. shq. II Ep. legj., v. I, 52).

2) Foljet tipike për shprehjen e aspektit të fillimit të veprimit janë *filloj, nis e zë*. Nga këto folje *filloj* ka filluar të përdoret gjithnjë e më shumë. Në përdorimin e këtyre tri foljeve në gjuhën letrare nuk vërehet ndonjë ndryshim stilistikor. Si folje aspektive këto nuk shprehin as veprim as gjendje; kuptimi leksikor i tyre është mjaft i zbehur, prandaj ato sot mund të pranohen si folje gjysmëndihmëtare. Ndryshe nga këto, foljet *marr, vihem* etj. në një përdorim të tillë karakterizohen nga ngjy-rime aspektive suplementare.

3) Nga pikëpamja semantike të dyja komponentet e konstruktit formojnë një njësi të vetme; konstrukt i tërësi tregon një veprim të vazhduar të përcaktuar në fillimin e tij. Nga pikëpamja gramatikore e para e drejton të dytën. Funkzioni i komponentës së parë është të tregojë momentin kur fillon veprimi, i së dytës është të tregojë kohën, gjatë së cilës kryhet veprimi. Kur si komponente e dytë përdoret një folje në paskajore ose përcjellore, koha gjatë së cilës vazhdon veprimi bëhet e qartë nga konteksti, sidomos kur folja aspektive është në të kryerën e thjeshtë. Në rastet e tjera ajo bëhet e qartë edhe nga vetë folja aspektive.

4) Lidhur me strukturën e këtyre konstruktëve është e rëndësishme të vihet në dukje që struktura e *kryer e thjeshtë + e tashme*, meqë shpreh një veprim a gjendje që kryhet në momentin e ligjërimin, përdoret zakonisht në dialoge, ndërsa struktura e *kryer e thjeshtë + e pakryer* përdoret në fjalët e autorit, përgjithësisht në ato raste kur për ngjarje e fakte të kaluara flitet nga pikëpamja e së tashmes. Pikërisht për këtë arsye përdorimi i së tashmes në vend të së pakryerës, me përjashtim të rasteve kur përdoret si e tashme historike, duhet quajtur i gabuar, si një fenomen që është në kundërshtim me gjuhën e folur dhe që i rruadh mundësitë shprehëse të shqipes.

5) Në analizën sintaksore këto konstruktë duhen analizuar si një gjymtyrë e vetme e fjalisë, si një kallzues i përbërë. Një pohim i tillë mbështetet vetëm në konsiderata semantike, e pikërisht në faktet se: a) foljet aspektive nuk kanë pavarësi kuptimore, ato janë shndërruar në folje gjysmëndihmëtare; b) i tërë konstrukt i nga pikëpamja kuptimore formon një njësi; c) kuptimi aspektiv i vazhdimësisë është rezultat i konstruktit në tërësi e jo i ndonjerës prej komponenteve.

T'i ndash këto folje në analizën gramatikore në dy bërthama kallzuesore të dy fjalive, do të thotë të prishësh unitetin semantik të konstruktit dhe të mos nxjerrësh në pah kuptimet aspektive që fiton ai.

R é s u m é

CONSTRUCTIONS A VERBES INCHOATIFS EN ALBANAIS

A l'albanais manquent les moyens morphologiques pour exprimer l'idée d'un action à son début, mais, comme d'ailleurs beaucoup d'autres langues indo-européennes contemporaines, il exprime cette idée par des

3) M. Çeliku, art. i cit., f. 162.

moyens lexicaux, par les verbes inchoatifs, verbes au sens lexical réduit, qui précèdent un verbe indiquant une action ou un état. Tels sont en albanais les verbes: filloj, zë, nis, marr, vihem, bëj, vij, mbes, qes, hyj. De ceux-ci: filloj, zë, nis, marr, vihem, bëj et vij sont d'usage courant dans la langue littéraire; qes, mbes et hyj sont dialectaux. Si on les envisage au point de vue de leur usage dialectal, on remarque que pour le tosque parlé populaire sont caractéristiques les verbes zë, bëj et vij; au contraire, pour le guègue parlé populaire sont caractéristiques nis, za, marr, vihem, baj, vij, mbes et hyj. Filloj, comme verbe inchoatif, est caractéristique de la langue littéraire. Dans le tosque parlé populaire il n'est pas employé; il n'est pas employé de même aussi par plusieurs auteurs tels Naim Frashëri, Sami Frashëri, Fan Noli, Mihal Grameno, etc. Le petit nombre de cas de son utilisation dans le guègue parlé populaire peut être considéré comme une influence de la langue écrite.

Tous ces verbes n'expriment pas, dans leur usage quotidien comme verbes inchoatifs, l'action ou bien un état comme les autres verbes servant de noyau prédicatif d'une proposition; ils représentent le moyen lexical pour exprimer l'idée de l'aspect d'une action. Sous cet aspect, typiques sont les verbes: filloj, zë, nis. Les autres verbes sont caractérisés par des nuances aspectuelles supplémentaires. Les verbes: marr, vihem, bëj et qes, à côté du sens inchoatif qui se fait jour dans des constructions données, indiquent aussi une introduction énergique et rapide dans l'action exprimée par le verbe qui les suit. Au contraire, les verbes vij et hyj indiquent une introduction calme et lente.

L'aspect inchoatif est exprimé au moyen des constructions suivantes:

I) Construction de coordination:

- a) verbe inchoatif + e (edhe) + verbe à l'indicatif
- b) verbe inchoatif + verbe à l'indicatif

II) Construction de subordination:

- a) verbe inchoatif + verbe au conjonctif
- b) verbe inchoatif + verbe à l'infinitif
- c) verbe inchoatif + verbe au gérondif.

Les constructions de coordination sont caractéristiques pour la langue parlée populaire, notamment pour le tosque. Dans le guègue parlé populaire, à côté des constructions de coordination, mais un peu plus fréquemment que celles-ci, sont en usage ces constructions de subordination, au deuxième composant à l'infinitif et au participe. Dans la langue littéraire prédominent les constructions de subordination, ayant le deuxième composant au subjonctif. Les verbes: zë, nis, marr, vihem et filloj, en tant que verbes inchoatifs, sont usités aussi dans des constructions à coordination. Le verbe bëj est usité dans les seules constructions de subordination.

Au point de vue structurel, un intérêt particulier offrent les constructions de coordination et celles de subordination, dont le deuxième composant est un verbe au conjonctif.

Si on l'envisage sur le plan temporel, il ressort que la structure des constructions de coordination est identique, dans ses lignes générales, à celles des constructions de subordination.

Au point de vue du sens, ces deux verbes forment un tout unique, à contenu communicatif unique, où le poids sémantique est tenu par le deuxième composant de la construction; en revanche, le premier indique l'idée de l'action exprimée par le deuxième composant. Etant déterminé déjà à son début, l'action exprimée par de telles constructions est extériorisée comme un processus qui se prolonge, qui commence et se continue. Dans ces constructions, le premier composant indique le temps du commencement de l'action, le deuxième indique la durée de cette action.

Au point de vue grammatical, le deuxième composant relève du premier, du verbe inchoatif. On voit cela non seulement dans les constructions de subordination, mais aussi dans l'usage parfois d'une forme temporelle du deuxième composant en dépendance de la forme temporelle du premier membre.

Dans l'analyse structurelle et sémantique de ces constructions, un intérêt tout particulier offre la structure qui a le premier composant au passé simple. Dans ces cas, le deuxième composant peut être à l'imparfait, au présent et au passé simple. Quand le deuxième composant est un verbe à l'imparfait, aussi bien le commencement que la durée de l'action appartiennent à la période temporelle d'avant l'instant d'extériorisation, la durée de l'action n'a rien à faire avec l'instant d'extériorisation. La structure au deuxième composant au présent indique une action qui a commencé naguère avant l'instant de l'extériorisation et dure aussi dans cet instant. Dans la langue écrite est observée, à partir de la Renaissance albanaise, une tendance à utiliser le présent au lieu de l'imparfait. Cette tendance est presque régulière chez les auteurs guègues (dans les cas d'usage du conjonctif comme deuxième composant). Un tel phénomène n'a pas lieu dans le tosque parlé populaire ni dans le guègue, étant donné que dans ce dernier dialecte, comme deuxième composant rentre l'infinitif. A l'avis de l'auteur, ce phénomène tire sa source du guègue écrit, où le conjonctif substitue de plus en plus l'infinitif. Les auteurs guègues, sous l'influence de leur parlars, n'arrivent pas souvent à comprendre la distinction temporelle faite par le tosque dans l'usage du présent et de l'imparfait dans ces constructions et, en général, quand le conjonctif relève d'un autre verbe. Pour ceux-ci, le présent est, dans ces constructions, aussi neutre au point de vue du temps que l'infinitif. Un tel usage du présent au lieu de l'imparfait doit être éliminé de la langue littéraire comme un phénomène qui ne s'appuie pas sur le langage populaire et qui limite les possibilités expressives de l'albanais.

Une place particulière ont les structures aux deux composants au passé simple. Ils sont compris dans les constructions de coordination et indiquent une action déterminée dans ses lignes générales non seulement à son début, mais aussi à sa fin. Elles sont caractéristiques au langage populaire. Comme verbes inchoatifs sont usités: zè, marr, vihem, vij, qis et mbes.

Dans l'analyse syntaxique, ces constructions doivent être analysées comme un seul membre de la proposition, comme un prédicat composé. Une telle affirmation s'appuie sur les seules considérations sémantiques, et précisément sur les faits que: a) les verbes inchoatifs n'ont pas une indépendance de sens, ils se sont réduits à des verbes semi-auxiliaires; b) l'entière construction forme, au point de vue de l'acceptation, une unité; c) le sens aspectif de continuité ou de durée est le résultat de la construction en général et non point de l'un de ses composants.